

VENDIM
Nr.38 datë 23.8.2005

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË NJOFTIMIT PËR PARAQITJEN E
APLIKIMIT PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E H/C TË RI SASAJ NGA SHOQËRIA
WONDER SHA**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, geramat ç dhe dh, nenit 15 pika 1 dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 11 pika 2 të ligjit nr.7973, datë 25.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” me ndryshimet përkatëse, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” me ndryshimet përkatëse, neni 11; Bordi i Komisionerëve të ERE – s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2005, pasi shqyrtoi njoftimin për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri Sasaj nga shoqëria Wonder sh.a.,

VENDOSI :

1. Për mospranimin për shqyrtim të njoftimit për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri Sasaj nga shoqëria Wonder sh.a., pasi njoftimi dhe aplikimi duhet të kryhen nga shoqëria koncesionare në zbatim të nenit 4 të marrëveshjes së koncesionit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.501, datë 23.7.2004.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit të njoftojnë shoqërinë Wonder sh.a. dhe ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga shoqëria koncesionare, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema